



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.124/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti Kryesues, Kujtim Pasuli dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike dhe private, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;24.01.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.124/2025 e datës 22.01.2025.
- II. Subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 4,000.00 (katërmijë) euro,
- III. Detyrohet subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### A r s y e t i m

Me datë;22.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës(PDK), me të cilën pretendon se më datë;22.01.2025 Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, ka identifikuar posterin e vendosur në hapësirë publike të kandidatit të PDK-së për deputet, Hajdar Beqa, i vendosur në rrugën "Tirana" në Prishtinë. Me këtë veprim kandidati dhe subjekti politik PDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1, nën-paragrafi 1. të LPZ-së. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e posterit në kundërshtim me LPZ.

Më datë;23.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë deri më datë;24.01.2025 në ora 09:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë;24.01.2025, subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka kërkuar nga PZAP që ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, ta refuzojë si të pa bazuar dhe lidhur më këto pretendime PDK njofton PZAP se shfrytëzuesi i kësaj prone, e cila gjendet në ngastrën kadastrale nr.7671/0, z.Besim Fazliu ka lidhur kontratë me NP IHK "Infrakos" Sh.a për dhënien me qira të banesës-pronës së Ndërmarrjes Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës SH.A-Infrakos, dhe se i njëjti si shfrytëzues legjitim i kësaj ngastre kadastrale në cilësinë e qiramarrësit, ia ka dhënë z.Hajdar Beqa pëlqimin për shfrytëzimin e kësaj hapësire për vendosjen e posterit, i cili është objekt i kësaj anekese, andaj kandidati për deputet nga radhët e PDK ka pasur një marrëveshje valide me gojë të cilën e ka lidhur me mirëbesim me ofruesin e shërbimeve, të cilën e konsiderojmë se në legjislacionit në fuqi e njëjta marrëveshje krijon efekte për palët si për të drejtat ashtu edhe për detyrimet e tyre, ku ndër të tjerash si detyrim i kandidatit tonë ka qenë pagesa e një shume të caktuar në bazë të marrëveshjes, kundrejt hapësirës reklamuese.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë thekson po ashtu, se kandidati për deputet z.Hajdar Beqa pëlqimin për shfrytëzimin e kësaj hapësire e ka pranuar në menyrë verbale pasiqë për qëllim të nenit 34 paragrafi 1, nenparagrafi 1.2, pëlqimi jo modeomos duhet të jepet në menyrë verbale mirëpo është e nevojshme që ky pëlqim të jepet në ndonjë formë e që në rastin konkret,pëlqimi nga z.Hajdar Beqa-shfrytëzues i kësaj prone privatë, është marr në mnyrë verbale nga z.Hajdar Beqa dhe rrjedhimisht i njëjti ka ndermarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të shfrytëzimit të hapësirës përkatëse e cila është objekt i kësaj anekese, e të cilat i ka berë para se ta vendos posterin në të njëjtën rrugë.

Po ashtu në përgjigje theksohet edhe se kandidati për deputetë z.Hajdar Beqa me qëllim të evitimit të çfrëdo pasoje eventuale të vendosjes së këtij posteri, në momentin që është njoftuar për ankesën, ka ndërmarrë të gjitha masat përmirësuese duke larguar posterin nga hapësira përkatëse.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë si prova ka bashkangjitur: kontratën nr.prot 659/2 e datës;24.05.2024 për dhënien më qira të banesës-pronës së Ndërmarrjes Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës SHA-Infrakos, e lidhur ndërmejt NP IH "INFRAKOS" Sh.a si qiradhënëse, dhe z.Besim Fazliu si qiramarrës, po ashtu ka bashkangjitur edhe fotografën lidhur me gjendjen e hapsirës pas ndërmarrjes së masave përmirësuese.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës gjeti se, ankesa është e bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe.përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik PDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik PDK, gjegjësisht e kandidati për deputet nga ky subjekt politik ka vendosur banerë/posterëve në hapësirë publike, apo private, ku me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se "*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe*

*që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Subjektit politik PDK në përgjigje në ankesë ka kundërshtuar ankesën e parashtruesit duke theksuar se posteri i kandidatit nga radhët e PDK, Hajdar Beqa, është vendosur në hapësirën private, dhe i cili ka dhënë pëlqimin paraprak në mënyrë verbale. Për Panelin këto pretendime janë të pa bazuar, për faktin se posteri është vendosur pa pëlqim me shkrim nga pronari në hapësirat të marrë në shfrytëzim nga personi privat, kurse në rastet kur posteri vendoset në hapësirat publike, atëhere është dashur të sigurohet leje e veçantë nga Drejtoria përkatëse, në Komunën e Prishtinës.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimin ankimore se kandidati për deputet z.Hajdar Beqa me qëllim të evitimit të qfarëdo pasoje eventuale, në momentin që është njoftuar për ankesën ka ndërmarrë të gjitha masat përmirësuese, duke hequr banerin nga kjo hapësirë, mirëpo këtë pretendim paneli e vlerëson si të bazuar për faktin se pas shikimit të fotos së dorëzuar me përgjigje në ankesë, verën se foto e dorëzuar me të cilën pretendon se është hequr posteri nuk i përket vendit ku gjindet fotografia, e cila është dorëzuar nga ankuesi me ankesë, dhe në këtë kuptim të njëjtin pretendim e vlerëson si të pa bazuar.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore dhe në këto zgjedhje, kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj vendosja e posterëve-njoftimeve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në vende të cilat kërkohet leje me shkrim nga organi publik apo personi që organi publik ia ka dhënë në shfrytëzim atë hapësirë, e rrjedhimisht nga kjo edhe një veprim i tillë përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, dhe të njëjta shkelje janë sanksionuar me dispozitat ligjore të nenit 34.1 paragrafi 1.2 të LZP-së.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla ankimore janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.124/2025, datë;24.01.2025



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.*